
**PLANI I INTEGRITETIT
I INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË
MBROJTJES SË TERRITORIT
2023-2025**

DEKLARATA E INTEGRITETIT

Plani i integritetit për institucionin tonë është një hap i rëndësishëm për të zhvilluar një sistem më të gjerë në lidhje integritetin, etikën dhe transparencën si pjesë të qenësishme që i shërbejnë mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit institucional të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit si edhe në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është strukturë e rëndësishme e cila ka si objektiv kryesor kontrollin e të gjithë territorit në fushën e ndërtimeve të kundërligjshme, të parandalimit, mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe kontrollit/inspektimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.

Përmes vlerësimit të risqeve të integritetit sipas fushave funksionale që ka IKMT-ja, zbatimi i Planit të Integritetit do të ndikojë në përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe performancën e IKMT-së për përmbushjen e përgjegjësisë e të ngarkuara si edhe në përmirësimin e imazhit të tij si institucion duke rritur besimin tek qytetarët.

KRYEINSPEKTOR

Afrim QENDRO



PËRMBAJTJA

DEKLARATA E INTEGRITETIT.....	1
PËRMBAJTJA.....	3
LISTA E SHKURTIMEVE	4
HYRJE	5
QASJA METODOLOGJIKE.....	5
RISQE DHE FAKTORËT E RISQEVE TË LIDHURA ME INTEGRITETIN TË IDENTIFIKUARA NË INSPEKTORATIN KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT	8
I. Veprimtaria operacionale	8
Risqe në fushën e inspektimeve/mbikqyrjes së territorit në fushën e ndërtimeve, mjedisit dhe pyjeve.....	8
II. Veprimtaria administrative.....	11
2.1 Risqe në menaxhimin financiar dhe buxhetit	11
2.2 Risqe në menaxhimin e aseteve.....	12
2.3 Risqe në menaxhimin e burimeve njerëzore.....	13
2.4. Risqe në fushën e praktikave administrative dhe ligjore	16
III. Menaxhimi i informacionit	16

LISTA E SHKURTIMEVE

IKMT	- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
DITP	- Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit
DIP	- Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve
DIMU	- Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave
DSHMF	- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës
DIJ	- Drejtoria e Inspektimit Juridik
DZV	- Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve
DIJ	- Drejtoria e Informacionit, Kontrollit të të Dhënave dhe Marëdhënieve me Publikun
DR	- Drejtoritë Rajonale të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit
GP	- Grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit
PI	- Plani i Integritetit
KDI	- Koordinator i për të Drejtën e Informimit
IP	- Inspektoriati i Përgjithshëm

HYRJE

Ndërtimi i integritetit është mjeti më efikas për parandalimin e korrupsionit dhe tipar dallues i çdo institucioni të një vendi demokratik. Për këtë arsye të gjitha institucionet shtetërore në Shqipëri i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë ndërtimit të integritetit dhe luftës kundër korrupsionit përmes, ndër të tjera, vlerësimit të risqeve të korrupsionit dhe hartimit të planeve të integritetit.

Në këtë kuadër edhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është përfshirë në këtë proces dhe ka hartuar Planin e Integritetit si një instrument për forcimin e integritetit të institucionit strukturues.

Ky plan vijon me miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Planit të Veprimit në zbatim të tij, me anë të të cilin janë identifikuar disa fusha me risqe edhe për Inspektoriatin Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Plani i integritetit fokusohet në adresimin e risqeve të integritetit në tre fusha kryesore:

1. Veprimtaria inspektuese dhe kontrolluese e cila identifikon risqet në fushën e inspektimeve për mbikëqyrjen e territorit lidhur me ndërtimet, mjedisin dhe pyjet dhe parashikon aktivitete dhe masa ndërhyrëse për të adresuar këto risqe.
2. Veprimtaria administrative identifikon risqet në menaxhimin financiar, në menaxhimin e asetëve, në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe në menaxhimin e proceseve dhe praktikave ligjore.
3. Menaxhimi i informacionit fushë, i cili identifikon risqe që lidhen me komunikimin, menaxhimin e shërbimeve online, pajisjeve elektronike dhe programet specifike që përdoren në institucion si dhe komunikimi e transparenca me publikun, parashikon masa për adresimin e këtyre risqeve.

Nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit janë evidentuar 18 risqe për të cilat janë parashikuar rreth 53 masa/aktivitete me qëllim përmirësimin e punës në shumë hallka të institucionit.

Një falenderim i veçantë shkon për ekspertin z. Arjan Dyrmishi, përfaqësues i Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS), për ekspertizën e dhënë në hartimin e këtij Planit Integriteti.

QASJA METODOLOGJIKE

Planit i Integritetit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit u hartua në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr. 334, datë 07.10.2020 *“Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”*, dokument i cili i është referuar Standardeve ISO 31000 dhe 31010¹, të përshtatura për analizën e riskut të integritetit, gjithashtu dhe duke shfrytëzuar metodat dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Ky proces për Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit kaloi në disa faza:

Nëpërmjet Urdhrit me nr.192, datë 18.03.2025 *“ Për disa ndryshime të Urdhrit Nr.135, datë 27.04.2022”* për *“Hartimin e Planit të Integritetit”* në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 01.07.2020 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve dhe pikës 5, të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.12, datë 21.01.2022 “Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Planit të Veprimit 2022-2024”* u ngrit grupi i punës me pjesëmarrës nga drejtoritë e insitucionit për hartimin e këtij plani.

Së dyti, u hartua një plan pune, ku u përcaktuan afatet, masat dhe aktivitetet e planifikuara, me qëllim përgatitjen dhe përfundimin në kohë të Planit të Integritetit dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij.

Së treti, u zhvilluan takime të vazhdueshme të anëtarëve të grupit të punës, ku u diskutua mbi vijimësinë e procesit dhe detyrat e secilës strukturë.

Përfaqësuesja e ministrisë na mbështeti në fillim të këtij procesi me ekspertizën e saj mbi etapat dhe hartimin e këtij plani integriteti dhe eksperti i CIDS në vijim duke qenë pjesë e takimeve të Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit që zhvilluan me anëtarët e GP, mbi metodologjinë e hartimit të analizës së riskut.

Grupi i Punës u angazhua për përgatitjen e një analize të thelluar të situatës dhe të bazuar në specifikat e strukturave të përfshira, duke shqyrtuar në mënyrë të hollësishme çdo aspekt dhe proces pune. Ky proces përfshinte disa komponentë, si më poshtë:

Analiza administrative që përfshiu:

1. Analizën e kuadrit ligjor që lidhet me risqet në aspektin e mangësive apo mbivendosjes ligjore, strukturën e insitucionit në qendër dhe në 12 qarqet e vendit;
2. Analizën e procesit të rekrutimit dhe trajnimet për punonjësit;
3. Analizën e menaxhimit financiar, menaxhimit të fondeve, shkëmbimit të informacionit si edhe shërbimet online.

Analiza operacionale:

4. Problematikat që dalin në inspektimin dhe kontrollin e territorit nga trupa inspektuese në ndërtim, mjedis dhe në pyje;
5. Identifikimi i mungesës infrastrukturore logjistike në inspektim;
6. Problematikat që dalin në sistemin online E-inspektimit nga trupa inspektuese në mjedis dhe në pyje;
7. Identifikimi i rasteve dhe fushave të inspektimit të ngjarjeve korruptive në të kaluarën, duke analizuar faktorët nga kanë ardhur këto risqe;

Në fund të këtij procesi, u hartua *Matrica e Riskut* për IKMT-në, ku përveç identifikimit të fushave të riskut edhe faktorëve që ndikuan në prezencën e riskut, grupi i punës hartoi masat/aktivitetet që duhet të marrë çdo drejtori për të trajtuar, zvogëluar apo zhdukur riskun.

Pas hartimit të kësaj matrice grupi i punës vijoi me hartimin e dokumentit të Planit të Integritetit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit si edhe të Planit të Veprimit 2023-2025.

RISQE DHE FAKTORËT E RISQVEVE TË LIDHURA ME INTEGRITETIN TË IDENTIFIKUARA NË INSPEKTORATIN KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT

I. Veprimtaria inspektuese dhe kontrolluese

Risqe në fushën e inspektimeve/mbikqyrjes së territorit në fushën e ndërtimeve, mjedisit dhe pyjeve.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është një institucion ligjzbatues, i specializuar në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, ku me ndryshimin e VKM-së për fushën e përgjegjësisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përcaktuar me Vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme*”, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit i’u shtua edhe përgjegjësia mbi “*parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji*”.

Nisur nga këto përgjegjësi dhe detyra funksionale, IKMT-së i është shtuar një numër i madh inspektorësh të trupës inspektuese e cila është e ndarë në trupën inspektuese në qendër dhe në drejtoritë rajonale në 12 qarqe, duke mbuluar gjithë territorin e vendit. Për të mbikqyrur dhe kontrolluar gjithë territorin inspektoratit i duhet një bazë e gjerë logjistike dhe infrastrukture të specializuar si edhe burime njerëzore profesionale, për arritjen e qëllimit për të cilën është krijuar ky inspektoriat si edhe detyrave të shtuara të tij.

Disa nga fushat me risk me të cilat përballen trupa inspektuese, inspektorët e kontrollit të mjedisit dhe territorit, të evidentuara në këtë aspekt janë:

1. Mosnjohja e plotë e kuadrit ligjor nga ana e gjithë trupës inspektuese ku si faktorë të kësaj fushe me risk mund të përmendim mosplotësimin sipas parashikimeve ligjore të formateve tip të inspektimit, mungesa e trajnimit të inspektorëve me dispozitat ligjore dhe ndryshimet e tyre, mosplotësimi i kriterëve të pozicioneve të punës për trupën inspektuese.
2. Mungesa e kapaciteteve logjistike për kryerjen e inspektimeve nga strukturat inspektuese në IKMT me faktorë risku, mungesa e aparaturave matëse për trupën inspektuese të mjedisit dhe ujrave, mospajisja me aparatura matëse për trupën inspektuese në pyje, mungesa e veshjeve me siglën identifikuese të institucionit për trupën inspektuese të IKMT, mungesa e fondeve në buxhet, mungesa e vendeve të punës së dedikuar për secilin punonjës në Qendër dhe në Qarqe.
3. Mospajisja e trupës inspektuese me dokumentacionin paraprak, të rregullt dhe ligjor për inspektimin në terren ku si faktor risku janë evidentuar, kryerja e inspektimit pa dokumentin e autorizimit nga ana e inspektorëve për arsye personale, mungesa e dërgimit të njoftimit nga inspektorët në subjektet e licensuara, mosdhënia në kohë e dokumentacionit nga ana eprorëve.
4. Shfrytëzimi, përpunimi dhe tregtimi i materialit drusor, në fondin pyjor kombëtar pa dokumentacionin përkatës dhe jasht kriterëve, me faktorë risku. Mungesa e informacioneve periodike të nevojshme nga strukturat menaxhuese pranë Bashkive për Fondin Pyjor dhe Kullosor dhe Zonave të Mbrojtura, mungesa e formularit tip për dokumentacionin e nevojshëm që duhet të kenë subjektet që ushtrojnë këtë veprimtari, mungesa e kapaciteteve teknike.
5. Problematikat në sistemin online (E-inspektime), ku si faktor risku janë evidentuar disa, siç janë mosfunksionimi i sistemit për hedhjen e planeve mujore të punës pa të cilin nuk mund të zhvillohet inspektimi online, mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për inspektorët, mosfillimi i aplikimeve të inspektimeve online në fushën e ndërtimit.
6. Mosndalimi në kohë i dëmtimeve në pyje, ku faktorë risku janë mungesa e informimit për dëmet në Fondin Pyjor dhe Kullosor, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet drejtorive rajonale, mungesa e kapaciteteve logjistike.

7. Mosekzekutimi i vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshme ku si faktor risku cilësojmë mungesën e mjeteve teknike specifike (eskavatorë) në prishjen e shtesave të cilat duan mjete të specializuara për tu prishur.

Me qëllim përmirësimin e inspektimit dhe të procedurave inspektuese në fushën e kontrollit të territorit, ndërtimeve, mjedisit, ujrave dhe pyjeve kemi parashikuar disa masa/aktivitete konkrete të cilat konsistojnë në:

- Shtimin e monitorimeve për inspektimet dhe kontrollet në territor nga eprorët përkatës,
- Inspektimet në territor të bëhen vetëm nëpërmjet autorizimit për inspektim,
- Trajnimi i inspektorëve për procesin e përpilimit të dokumentacionit të inspektimit sipas dispozitave ligjore.
- Azhornimi i legjislacionit dhe njohja me ndryshimet për trupën inspektuese.
- Marrja në punë e inspektorëve sipas kriterëve të përcaktuara sipas pozicioneve të punës. Kërkesa shtesë për buxhet drejtuar organit epror.
- Shkresa dhe diskutime drejtuar organit epror për lirim të vendeve të punës në katin e katërt të godinës, ku ende prona zyrtarisht rezulton IKMT-ja. Marrja e masave ndaj inspektorëve të cilët nuk janë pajisur me autorizimin përkatës.
- Evidentimi i rasteve dhe marrja e masave përkatëse.
- Plotësimi në kohë me dokumentacionin ligjor për inspektim nga ana e eprorëve. Marrja e informacioneve periodike të nevojshme nga strukturat menaxhuese pranë Bashkive për Fondin Pyjor dhe Kullosor dhe Zonave të Mbrojtura.
- Shtimi i kapaciteteve teknike. Rritja e komunikimit të vazhdueshëm me Inspektoratin e Përgjithshëm nga drejtoritë në qendër dhe në qarqe.
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme për inspektorët.
- Fillimi i aplikimit të inspektimit online në fushën e ndërtimit.

Rezultatet e parashikuara për t'u arritur përmes zbatimit të planit të integritetit në këtë fushë janë:

Rritja e profesionalizmit në ushtrimin e detyrës nga trupa inspektuese, rritja e monitorimit të inspektimeve, shtimi i kapacitetet logjistike për kryerjen e inspektimeve, përmirësimi i efektivitetit të punonjësve të IKMT-së, rritja e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve në vend, ulja e shfrytëzimit, përpunimit dhe tregtimit të materialit drusor pa dokumentacion ligjor, rritja e bashkëpunimit ndërmjet insitucioneve të mbrojtjes së pyjeve është rritur, fushën e ndërtimit dhe mjedisit si edhe rritja e bashkëpunimit me Inspektoratin e Përgjithshëm, forcimi i punës në mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, përmirësimi i inspektimit në fushën e ndërtimit, mjedisit dhe pyjeve, rritja e besimit të qytetarëve në institucionet publike dhe rritja e imazhit të IKMT.

II. VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

Nga analiza e mënyrës së funksionimit të IKMT-së, e bërë nga grupi i punës, fushat me risk u ndanë në dy fusha kryesore: fusha administrative dhe fusha e inspektimeve/kontrolleve në territor.

Fusha administrative sipas funksionalitetit është e ndarë në 3 nënfusha të tjera:

2.1 Riske në menaxhimin financiar dhe buxhetit

Menaxhimi financiar është një fushë me rëndësi të veçantë që përfshin risqe të konsiderueshme të mundshme të lidhura me korrupsionin. Menaxhimi i financave të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në mënyrë që përdorimi i burimeve financiare të jetë sa më eficient, efektiv dhe ekonomik duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë. Vendimmarrja brenda institucionit është e bazuar në rregullime ligjore dhe hierarkike mbi ekzekutimin e fondeve publike, kryerjen e pagesave sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimet përkatëse për të shmangur shpërdorimet apo keqërdorimin e fondeve buxhetore.

Risqet të identifikuara në këtë fushë mund ti specifikojmë si më poshtë:

1. Planifikimi i shpenzimeve buxhetore të institucionit jo sipas kërkesave të drejtorive apo nevojave prioritare dhe të pabazuara në një proces gjithëpërfshirës dhe transparent diskutimi.

Pas evidentimit të këtij risku, vlerësuam faktorët që çojnë në ekzistencën e këtij risku në menaxhim që janë:

- ✓ Kërkesa buxhetore nga drejtoritë rajonale dhe qendrore të paargumentuara dhe të pastandartizuara;
- ✓ Kërkesa Buxhetore të dërguara jashtë afateve ligjore të përcaktuara;
- ✓ Kërkesa buxhetore vetëm me sasi, të pashoqëruara me specifikimet teknike dhe kostot.

Me qëllim rritjen e integritetit në strukturën e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe zvogëlimin e risqeve të identifikuara më sipër, nga grupi i punës janë parashikuar disa masa apo aktivitete:

- ✓ Ngritja e grupeve të punës për përgatitjen e PBA;
- ✓ Përgatitja e kërkesave buxhetore nga të gjitha drejtoritë në qendër dhe rajone, brenda afateve të përcaktuara në udhëzimet e buxhetit;
- ✓ Zbatimi i buxhetit të miratuar në përputhje me atë të planifikuar;
- ✓ Trajnimi i strukturave të financës të Drejtorive Rajonale dhe Qendrore.

Rezultatet e parashikuara për t'u arritur përmes zbatimit të planit të integritetit në këtë nënfushë janë: Planifikimi i buxhetit i argumentuar dhe bazuar në kërkesat prioritare të drejtorive si edhe procesi i planifikimit të buxhetit transparent dhe gjithëpërfshirës me të gjithë menaxherët e strukturës.

2.2 Risqe në menaxhimin e aseteve

Menaxhimi i aseteve në institucion është i mbështetur në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse lidhur me ruajtjen, qarkullimin dhe përdorimin e aktiveve të institucioneve publike.

Inspektimi dhe kontrolli i cili shtrihet në gjithë territorin e vendit kërkon një angazhim rigoroz në lidhje me përdorimin e aseteve dhe rritjen e kontrollit të brendshëm për përdorimin sa më eficient

dhe efikas të tyre. Nga parashtrimet e bëra rezulton se, menaxhimi i asetëve është gjithashtu një fushë e ekspozuar ndaj riskut dhe çënimit të integritetit. Në këtë aspekt mund të përmendim disa procese me risk të shtuar si:

1. Përdorimi jo eficient i aktiveve qarkulluese dhe të qëndrueshme të trupëzuara ku si faktorë të riskut mund të themi që është lëvizja e aktiveve në disa raste pa dokumente justifikuese.
2. Lëvizja e aktiveve në disa raste pa dokumente justifikuese ku si faktor risku mund të cilësojmë gjendjen e dokumentacionit të padorëzuar në arkivën e sistemit.

Në mënyrë që të rritet kontrolli i brendshëm në lidhje me këto risqe të evidentuara në fushën e asetëve, është e rëndësishme të merren disa masa kufizuese që janë:

- ✓ Përmirësimi i dokumentave standarte të lëvizjes së aktiveve;
- ✓ Monitorimi i administratës për furnizimet e mëparshme të secilit sektor;
- ✓ Inventarizimi i aktiveve brenda afatave;

3. Arkivimi, ruajtja e informacionit dhe administrimi i dokumentacionit është një fushë me rëndësi në veprimtarinë e institucionit, i cili sjell risqe si:

1. Mos dorëzimi brenda afatave të parashikuar nga ligji i fondit ose dëmtim arkivor, ku si faktor risku është gjendja e dokumentacionit të padorëzuar në arkivën e sistemit.

Në këtë kuadër masat që do të merren nga institucioni janë:

- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës për ruajtjen, administrimin dhe dorëzimin korrekt të dokumentacionit në arkivën e sistemit.

Rezultatet e parashikuara për t'u arritur përmes zbatimit të planit të integritetit në këtë nënfushë janë: Aktive të përdorura në mënyrë sa më eficiente dhe dorëzimi i fondit arkivor në arkivën e sistemit.

2.3 Risqe në menaxhimin e burimeve njerëzore

Mirëfunksionimi i administratës ka nevojë për përcaktimin e procedurave rigoroze dhe të qarta të promovimit në karrierë, vlerësimit dhe dhënies së gradave duke mos favorizuar individë për arsye

preferenciale. Në këtë kuadër në zbatim të këtij Plani Integriteti janë parashikuar masat e mëposhtme:

- Njohja dhe bërja publike e çdo faze të procesit, lista e konkurentëve, vlerësimet e dosjeve, vlerësimet e performancës, vlerësimi i intervistës, i testeve të tjera fizike, psikologjike dhe profesionale.
- Bazë e plotë normative dhe procedura të hollësishme për zhvillimin e testimeve, intervistave, duke detajuar komponentët e vlerësimit dhe peshën specifike të çdonjërit prej tyre.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është një fushë e rëndësishme, e cila çënohet nga risqe me ndikime negative për institucionin, të cilat hasen në stadi të ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore si publikimi, emërimi, përzgjedhja, transferimi, largimi i personelit nga puna, miratimi, zbatimi apo ndryshimi i strukturës organizative, i rregulloreve, kodeve të ndryshme etj. dhe që mund të çënojë integritetin e institucionit duke ndikuar drejtëpërdrejtë në mirëfunksionimin e tij.

Rekrutimi në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë,

Riorganizimi sipas strukturës së re me ndryshimet e reja ligjore si edhe përshtatja e vazhdueshme organizative janë procese të nevojshme në interes të rritjes së efikasitetit të burimeve njerëzore në institucion.

Pas analizës së bërë në lidhje me procesin e rekrutimit në strukturat e institucionit, por në këtë proces hasim dhe risqet si:

3.1 Problematika në rekrutimin e punonjësve të institucionit

- ✓ Mungesa e hartimit të kriterëve për marrjen në punë të punonjësve.
- ✓ Mospublikimi i kriterëve për marrjen në punë të punonjësve.
- ✓ Mospublikimi në faqen zyrtare të IKMT-së i vendeve vakante të punës.

a. Mungesë e transparencës në rekrutim.

- ✓ Mospublikimi në faqen zyrtare të IKMT-së i vendeve vakante të punës.

b. Mungesa e realizimit të trajnimeve për punonjësit.

- ✓ Mungesa e një plani vjetor të trajnimeve.
- ✓ Mungesa e ofrimit të trajnimeve pa pagesë nga institucioni që ofron trajnime për administratën publike.
- ✓ Mungesa e hartimit të metodologjive për trajnim sipas fushave të përgjegjësisë të institucionit.
Mungesa e hartimit të pyetsorit për nevojat e punonjësve për trajnim për secilën drejtori.
- ✓ Mosidentifikimi i punonjësve që kanë nevojë për trajnim nga secila drejtori.
- ✓ Mungesa e hartimit të regjistrit të punonjësve sipas nevojave për trajnim nga burimet njerëzore në IKMT.

Në këtë kuadër në zbatim të këtij Plani Integriteti janë parashikuar masat/aktivitetet e mëposhtme:

- ✓ Hartimi i kriterëve për marrjen në punë të punonjësve.
- ✓ Publikimi i kriterëve për marrjen në punë të punonjësve.
- ✓ Publikimi i vendeve vakante sipas kriterëve për çdo pozicion pune.
- ✓ Hartimi i një plani vjetor të trajnimeve.
- ✓ Bashkëpunimi dhe komunikimi shkresor për ofrimin pa pagesë me institucionin që ofron trajnime për administratën publike.
- ✓ Hartimit të metodologjive për trajnim sipas fushave të përgjegjësisë së institucionit.
- ✓ Hartimi i pyetsorit për nevojat e punonjësve për trajnim për secilën drejtori.
- ✓ Identifikimi i punonjësve që kanë nevojë për trajnim nga secila drejtori.
- ✓ Hartimi i regjistrit të punonjësve sipas nevojave për trajnim nga burimet njerëzore në IKMT.

Rezultatet e parashikuara për t'u arritur përmes zbatimit të planit të integritetit në këtë nënfushë janë:

Rekrutim sipas kriterëve të pozicionit të punës, rritja e profesionalizmit të punonjësve në institucion, rritja e transparencës së institucionit të IKMT-së, rritja e numrit të trajnuar të

punonjësve të IKMT-së, përmirësimi i punës së institucionit, përmirësimi i kontrollit dhe mbikqytjes në territorit.

2.4. Riske në fushën e praktikave administrative dhe ligjore

Struktura e Drejtorisë së Inspektimit Juridik e cila rregullon veprimtarinë juridike dhe legjislativë të institucionit dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët, në ndjekjen dhe zbatimin e vendimeve administrative përfundimtare, mbartin një risk potencial për cënimin e integritetit të punonjësit dhe të vetë institucionit.

1. Problematika në ndjekjen e proceseve gjyqësore, me faktorë risku mosarsyetime i duhur ligjor, mosdepozitimi i dokumentacionit të plotë në dosjen gjyqësore, mospërfaqësimi i duhur ligjor në drejtoritë rajonale si edhe problematikat që vijnë nga përpilimi i procedurës ligjore e trupës inspektuese.

Si masa për përmirësimin e këtij procesi janë kontrolli dhe monitorimi përfaqësimit ligjor nga eprorët përkatës, kontrolli i dokumentacionit të procedurës së ndjekur nga eprori direkt si edhe bashkëpunimi me drejtoritë e tjera të institucionit.

Rezultatet e parashikuara për t'u arritur përmes zbatimit të planit të integritetit në këtë nënfushë janë: Procese gjyqësore të fituara nga IKMT.

III. MENAXHIMI I INFORMACIONIT

Nga një hulumtim i bërë në faqen zyrtare të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit vihet re që kjo faqe përmban informacionin në lidhje me Programin e Transparencës, një detyrim i përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e së drejtës për informim. IKMT-ja e ka publikuar PT në faqen zyrtare të saj, i cili është plotësuar me informacionin e nevojshëm e të detyrueshëm sipas formatit të miratuar, por ka nevojë për plotësime të tjera në vijim. Në faqe është publikuar Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatori Antikorrupsion pranë IKMT-së. Gjithashtu vihet re që në këtë faqe ka informacion të hershëm dhe nuk është i përditësuar për shkak edhe të mungesës së

një punonjësi të teknologjisë së informacionit i cili mund të jetë ura lidhëse me Agjensinë Kombëtare të Informacionit për ndryshimin e formatit dhe rubrikave në faqe.

Risqe që lidhen me fushën e informacionit:

1. Mungesa e dërgimit në kohë e informacioneve periodike pranë drejtorisë së informacionit.
2. Problematikat në shërbimet online në sistemin e-Albania.
3. Vështirësi menaxheriale dhe bashkëpunimi me AKSHI për mundësimin e operimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë së informacionit.

Nisur nga këto fusha me risk evidentojmë faktorët e riskut që janë neglizhenca e dërgimit në kohë e informacioneve periodike në drejtorinë e informacionit, në 5 drejtori rajonale, mungesa e kapaciteteve në zyrat e drejtorive rajonale, mungesa e përditësimit të informacionit mbi aplikimet e dërguara nga qytetarët, mungesa e trajnimit të specialistëve pritës në lidhje me shërbimet, mungesa e njohurive dhe aftësive nga ana e qytetarëve për të aplikuar në sistemin E-Albania, mungesa e punonjësit të teknologjisë së informacionit në institucion.

Për të përmirësuar situatën e krijuar parashikojmë të marrim disa masa në këtë fushë:

- ✓ Dërgimi i shkresave dhe komunikimi telefonik në lidhje me dërgimin e informacionit.
- ✓ Marrja e masave disiplinore për punonjësit përgjegjës.
- ✓ Trajnimi i mëtejshëm i specialistëve të rinj për dërgimin e këtij informacioni.
- ✓ Shtimi i kapaciteteve teknike për realizimin e detyrave funksionale.
- ✓ Komunikimi i vazhdueshëm me specialistët e teknologjisë së informacionit për problematikat teknike në sistem.
- ✓ Trajnimi i specialistëve pritës në lidhje me shërbimet.
- ✓ Dhënia e asistencës për qytetarët nga specialistët pritës për të aplikuar në sistemin E-albania.
- ✓ Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të aplikuar online për shërbimet.
- ✓ Emërimi i një punonjësi për teknologjinë e informacionit pranë IKMT-së.

Rezultatet e parashikuara për t'u arritur përmes zbatimit të planit të integritetit në këtë fushë janë: Zgjidhja në kohë e problematikave në sistemin E-albania për shërbimet online të dhëna nga IKMT-ja, kthimi brenda afatit i përgjigjeve që vijnë në këtë sistem përmes E-albania nga qytetarët, përmirësimi i imazhit për shërbimet dixhitale, përmirësimi i punës në IKMT.

PLANI I VEPRIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Veprimit është një plan me afat 2-vjeçar, i cili përfshin tërësinë e masave që do të realizohen për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit si edhe strukturat përgjegjëse të cilat do të realizojnë këto masa. Plani i Veprimit të Planit të Integritetit do të zbatohet për një periudhë kohore 2023-2025.

1. Përmirësimin e proceseve të punës në mënyrë që të minimizohet çënimin i tyre nga risqet e integritetit;
2. Rritja e kapaciteteve logjistike dhe e pajisjeve matëse në fushën e inspektimit të territorit, mjedisit dhe pyjeve;
3. Burime njerëzore të trajnuara dhe profesionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit;

KONLUZIONE

Sipas analizës në tërësi të bërë nga ky grup pune për veprimtarinë e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit arrijmë në disa përfundime të përbashkëta të masave që duhet të merren në fushat me risk, që janë rritja e kapaciteteve inspektuese si një domosdoshmëri për të arritur disa standarte në përputhshmëri me zbatimin e disa ndryshimeve ligjore të bëra rishtazi, trajnimi i punonjësve në tërësi dhe i trupës inspektuese në veçanti që do të mundësojnë një qëndrueshmëri në strukturat inspektuese në qendër dhe në drejtoritë rajonale nëpër qarqe për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit institucional si edhe në fund por jo më pak i rëndësishëm

është rritja e buxhetit të institucionit të IKMT-së për përballimin e nevojave në rritje si pasojë e shtimit të fushës së përgjegjësisë si edhe shtimit të numrit të punonjësve si pasojë e strukturës së re.

MONITORIMI

Zbatimi i Planit të Integritetit të Inpektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit do jetë në një proces të vazhdueshëm monitorimi dhe vlerësimi. Monitorimi do të kryhet nga koordinatori/koordinatorët që do të caktohen në IKMT.

Në kuadër të monitorimit, koordinatorët do të përgatisin dhe përcjellin raportimet vjetore pranë Kryeinspektorit, për zbatimin e masave, aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuar në Planin e Veprimit.

Bazuar në vlerësimin sasior dhe cilësor të arritjeve, rrethanave, risqeve dhe eksperiencave të mëparshme, problematikave të ndeshura në implementim, do të formulohen rekomandime për ndryshime në dokument, duke synuar kështu përmirësimin e vazhdueshëm të politikave institucionale në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe rritjes së integritetit.

Pas përfundimit të periudhës së zbatimit të Planit të Integritetit 2023-2025, do të përgatitet një raport përfundimtar vlerësimi, ku do të analizohen dhe vlerësohen rezultatet në aspektet e përmbushjes së objektivave, masave të ndërmarra, burimeve të investuara, efektivitetit si dhe do të identifikohen nevojat për vijueshmërinë e masave në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe ndërtimit të integritetit në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

INFORMACION PËRMBLEDHËS

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025

Plani i integritetit për IKMT është ndërtuar për të zhvilluar një sistem më të gjerë në lidhje me integritetin, etikën dhe transparencën si pjesë të qenësishme që i shërbejnë mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit institucional të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit si edhe në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit.

Plani i Integritetit është miratuar me Udhrrin nr.352, datë 21.12.2022 *“Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Punëve Brendshme dhe Planit të Veprimit 2023-2025”*.

Në planin e Integritetit për IKMT, janë evidentuar 18 risqe për të cilat janë parashikuar rreth 53 masa/aktivite me qëllim përmirësimin e punës në shumë hallka të institucionit.

Pas informacionit të pakët të mbledhur për secilën drejtori, për sa i përket masave të realizuara deri më tani të cilat i kemi përmbledhur në një tabelë ku bëjnë pjesë Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Informacionit, Kontrollit të të Dhënave dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit janë evidentuar 18 risqe të cilat janë:

1. Mosnjohja e plotë e kuadrit ligjor nga ana e gjithë trupës inspektuese ku si faktorë të kësaj fushe me risk mund të evidentojmë:
 - Trajtimi i inspektorëve për procesin e plotësimit të dokumentacionit të inspektimit sipas dispozitave ligjore;
 - Azhurnimi i legjislacionit dhe njohja me ndryshimet ligjore për trupën inspektuese;
 - Marrja në punë e inspektorëve sipas kritereve të përcaktuara në bazë të pozicioneve të punës.
2. Mungesa e kapaciteteve logjistike për kryerjen e inspektimeve nga strukturat inspektuese dhe për punonjësit e tjerë në IKMT me faktorë risku mund të evidentojmë:
 - Kërkesa shtesë për buxhetin drejtuar organit epror;
 - Aplikimi nëpërmjet projektit të hartuar nga institucioni ynë për thithjen e fondeve për

blerjen e kësaj baze materiale;

- Shkresa dhe diskutime organit epror për lirim të vendeve të punës në katin e katërt të godinës, ku ende pronar zyrtarisht rezultojnë IKMT-ja.
3. Mospajisja e trupës inspektuese me dokumentacionin paraprak, të rregullt dhe ligjor për inspektimin në terren ku si faktorë risku janë evidentuar:
- Marrja e masave ndaj inspektorëve të cilët nuk janë pajisur me autorizimin përkatës;
 - Evidentimi i rasteve dhe marrja e masave përkatëse;
 - Plotësimi në kohë me dokumentacionin ligjor për inspektim nga ana e eprorëve.
4. Shfrytëzimi, përpunimi dhe tregtimi i materialit drusor, në fondin pyjor kombëtar pa dokumentacionin përkatës dhe jashtë kriterëve, me faktorë risku:
- Marrja e informacioneve periodike të nevojshme nga strukturat menaxhuese pranë Bashkive për Fondin Pyjor dhe Kullosor të Zonave të Mbrojtura;
 - Përpilimi nga ana e drejtorisë së pyjeve të formularit tip që tregon dokumentacionin e nevojshëm që duhet të kenë subjektet që ushtrojnë këtë veprimtari;
 - Shtimi i pajisjeve matëse në pyje.
5. Problematikat në sistemin online (E-inspektime) ku si faktorë risku janë evidentuar:
- Rritja e komunikimit të vazhdueshëm me IP nga drejtoritë në Qendër dhe në Qarqe;
 - Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme për inspektorët;
 - Fillimi i aplikimit të inspektimit online në fushën e ndërtimit.
6. Moskthimi në kohë i përgjigjeve dhe ankesave që vijnë nga qytetarët në lidhje me ndërtimet e kundërligjshme ku si faktorë risku janë evidentuar:
- Komunikimi shkresor për zbatim të ligjshmërisë nga ana e IMT-ve;
 - Kontrolle të vazhdueshme për punën e bërë nga inspektorët e IMT-ve;
 - Shkresa dërguar IMT-ve për bashkëpunimin dhe respektimin e afateve ligjore.
7. Mosndalimi në kohë i dëmtimeve në pyje ku faktorë risku janë evidentuar:
- Marrja e informacionit në kohë për dëmtimet në pyje;
 - Rritja e bashkëpunimit me institucionet përkatëse;
8. Mosekzekutimi i vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshme ku si faktor risku evidentohet:
- Blerja e mjeteve (eskavatorë) në përmasat dhe specifikimet e duhura për prishjen e

- ndërtimeve specifike;
